



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT

Nr. 4681/16 Prot.

Fier, më 08/08/2017


**KONTRATE SIPERMARRJE ME OBJEKT :**

**“RIKONSTRUKSION I SHKOLLES ARTISTIKE ‘JAKOV XOXA’  
FIER”**

Drejtuar : Drejtoria e Shërbimeve Publike  
Këty

**PALET :**

- ❖ AUTORITETI KONTRAKTOR : BASHKIA FIER
- ❖ KONTRAKTOR : O.E. "KOLA INVEST" SH.P.K



## KONTRATE SIPERMARRJE

### **“RIKONSTRUKSION I SHKOLLES ARTISTIKE JAKOV XOXA FIER”**

Lidhur sot, më 08/08/2017 midis **Bashkise Fier**, perfaqesuar nga Administratori i Pergjithshem, **z.Florjan Muçaj**, ne mungese me me urdher te Titullarit te Autoritetit Kontraktor **z.Armando Subashi**, nga njera ane dhe operatorit ekonomik **"Kola Invest" sh.p.k.**, me perfaqesues ligjor te tij **z.Sofokli Kola** nga ana tjetere, te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

#### PERKUFIZIME:

1. **“Kontrate”** do te thote Kontrate Sipermarrje per objektin **“Rikonstrukcion i shkolles artistike 'Jakov Xoxa' Fier”**, me permbajtje dhe termat ne tekstin si me poshte. **“Kontratë”** do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkengjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
2. **“Vlefte e Kontrates”** eshte vlefte e plote ne leke perfshi TVSH e fituar ne tenderin e dates **03.07.2017** te organizuar ne Bashkine Fier per ndertimin e ketij Objekti.
3. **“Objekt”** do te thote **“Rikonstrukcion i shkolles artistike 'Jakov Xoxa' Fier”**, sipas Projektit te miratuar dhe Preventivit e Specifikimeve teknike te dhena e te pranuar ne tender.
4. **“Autoriteti Kontraktor”** eshte **BASHKIA FIER**.
5. **“Kontraktor”** eshte operatori ekonomik **"Kola Invest" sh.p.k.**, me numer NIPT **K93103401G**
6. **“Preventiv”** do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje. Volumet dhe cmimet per secilin ze jane pjese e Ofertes Fituese dhe pjese e kesaj kontrate.
7. **“Situacion Pjesor”** do te thote situacioni per nje pjese te punimeve te preventivit, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimet e fituara ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH.
8. **“Situacion Perfundimtar”** do te thote situacioni per punimet e plota te percaktuara ne preventiv, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimet e fituar ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH, brenda vleres se fituar ne tender.
9. **“Data e kryerjes se plote”** do te thote data qe ndertimet duhet te mbarohen sic eshte shprehur ne grafikun per kryerjen e Ndertimeve.
10. **“Kryerja”** do te thote data e vertetuar se Ndertimet jane mbaruar.
11. **“Difekt”** do te thote cdo pjese e ndertimeve e parealizuar ne perputhje me specifikimet teknike te kontrates.
12. **“Data e hyrjes”** do te thote data qe Autoriteti Kontraktor lejon Kontraktorin ne Objekt dhe marrjen prej tij ne dorezim te Sheshit te Ndertimit me proces-verbal.
13. **“Materiale”** do te quhen te gjitha furnizimet duke perfshire edhe ato te konsumueshme, cilesia e te cilave vertetohet me certifikate, te perdorura nga Kontraktori per trupezimim e tyre ne ndertimin e objektit.





14. “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit
15. “Mbikqyesi i punimeve” (Supervizori) do të thotë subjekt fizik/juridik i licensuar me të cilin AK ka lidhur Kontrate Mbikqyrje për ndertimin e Objektivit. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë përcaktuar në U.K.M. nr. 3 datë 15.02.2001 “Për Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndertimit” të ndryshuar, U.K.M. Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndertimit” dhe paraqiten në Kontraten e Mbikqyrjes.
16. “Kolaudatori” do të thotë subjekt fizik/juridik i licensuar me të cilin AK ka lidhur Kontrate për Kolaudimin e Objektivit. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë përcaktuar në U.K.M. nr. 3 datë 15.02.2001 “Për Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndertimit” të ndryshuar dhe paraqiten në Kontraten e Kolaudimit.
17. “Ndertime” do të thotë Projekt i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit, pjesë përberëse e Kontrates.
18. “Llogaritja e afateve” Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.
19. “Afati i Garancise se Punimeve” do të thotë periudha prej **24 muaj** e cila fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve, gjatë të cilit Kontraktori riparohet me shpenzimet e tij çdo defekt që ka ardhur si pasojë e cilesisë së punimeve të kryer prej tij.
20. “Garancia e Punimeve”, është vlera prej **5%** e vlefes së situacionit përfundimtar të miratuar.
21. “Baza ligjore” Kontrata do t’i nënshtrohet, do të qeveriset dhe do të interpretohet sipas ligjeve dhe dispozitave nënligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë, përfshirë të gjitha dokumentat e tenderit dhe të ofertës së Kontraktorit të cilat janë pjesë e kësaj kontrate sipas përmbajtjes së tyre.
22. “Force Madhore” do të thotë një ngjarje që nuk mund të kontrollohet nga palet, ku përfshihen, por nuk janë të limitizuara, lufta, revolucionet, zjarri përmytja, termeti, epidemite, karantina, embargo tranziti, etj.

## I. OBJEKTI I KONTRATES

“Rikonstruksion i shkollës artistike ‘Jakov Xoxa’ Fier”, sipas Projektit, Preventivit të miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike të pranuar në tender të cilat janë pjesë përberëse e kësaj kontrate dhe përbejnë detyrim ligjor për zbatim nga palet në këtë kontrate.

## II. VLEFTA DHE AFATI I KONTRATES

Vlefte e fituar në tender për përfundimin e punimeve në total sipas preventivit pa TVSH është **87 710 792 lekë** (tetëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e dhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy) dhe me TVSH është **105 252 950 lekë** (njëqind e pesë milion e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë), dhe afati i kryerjes së punimeve është 182 ditë nga nënshkrimi i kontrates.





Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Ne vleften totale te mesiperme perfshihet TVSH, si dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale ne Republiken e Shqiperise.

### **III. TE DREJTAT DHE DETYRAT E AK**


1. Te njohje zyrtarisht Kontraktorin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorezoje atij nga nje kopje te Kontrates se Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit. Nga ana e Bashkise Fier do te vendoset nepermjet procedures se prokurimit, si perfaqesues prane sipermarresit, mbikeqyresin e punimeve.
2. Te marre te gjitha masat pergatitore per lirimimin e Sheshit te Ndertimit dhe te lejoje Kontraktorin te hyje ne Objekt dhe ta dorezoje ate me proces-verbal ne prani te Mbikqyresit.
3. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës dhe Kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. *Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.* (Neni 18 i KPK tek DST)
4. Brenda dates se hyrjes te siguroje te gjitha lejet e nevojshme ligjore ne menyre qe t'i krijojte kushte pune normale Kontraktorit.
5. Te miratoje situacionin pjesor dhe situacionin perfundimtar te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyresi.
6. Te asistojte ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektivit.
7. Ka te drejte qe per te realizuar me se miri anen funksionale te Objektivit, te beje ndryshime jo thelbesore ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit. Ndertimet shtese mund te porositen vetem ne rrethana te percaktuar ne LPP dhe U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit" dhe me kusht qe shtesa e kontrates te mos i kaloje 20% te cmimit origjinal te kontrates.
8. Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e mëposhtëm (neni 36.3 i KPK ne DST):
  - a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
  - b) Korrigjime në materiale
  - c) Korrigjime në sasi
9. Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marreveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marreveshjes.
10. Te marre ne dorezim Objektivin pas kolaudimit perfundimtar.
11. Te vëri ne shfrytezim Objektivin dhe pas përfundimit te Afatit te Garancise te leshojte certifikaten e garancise se punimeve.



12. Te verifikojë kryerjen e riparimit të difekteve të ndodhura dhe për ato që nuk janë eliminuar llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bene ndalesën nga vlefata e garancisë së punimeve.
13. Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
  - a) kontraktori dështon në kryerjen e punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë;
  - b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim të detyrimeve dhe kushteve të kontratës për një afat 15 ditë të plotë, me përjashtim të rasteve kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

#### **IV. TË DREJTAT DHE DETYRAT E KONTRAKTORIT (SIPERMARRESIT)**

1. Te sigurojë Kontraten në vlerën 10% të vlefatës totale të kontratës para lidhjes së saj. Sigurimi i Kontrates të bëhet në formën e Garancisë Bankare ose Sigurimit në një nga shoqëritë e sigurimeve të licensuara.
2. Kontraktori është i detyruar të sigurojë pranë shoqërive të sigurimit, nga data e hyrjes në objekt deri në Afatin e Mbarimit të punimeve, të gjitha elementet e përcaktuara në pikën 6.1 të Shtojcës 18(KVK) të DST, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Të marrë në dorezim Objektin duke reflektuar në proces-verbalin përkatës gjendjen teknike të tij.
4. **Data e fillimit të punimeve është data e marrjes së Objektivit (sheshit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit) në dorezim si dhe emerimit të mbikqyresit të punimeve nga AK.**
5. Menjëherë pas lidhjes së kontratës, Kontraktori duhet t'i paraqesë mbikqyresit të punimeve një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.
6. Të caktojë drejtuesin/it teknik të tij në përputhje me licencën e paraqitur në tender, të cilët do të drejtojnë të gjitha punimet për zbatimin e Projektit të Zbatimit dhe të njoftojë zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe AK, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore të tij/tyre.
7. Të njohë, të respektojë termat e Kontrates të Mbikqyrjes dhe Kontrates së Kolaudimit dhe t'i krijojë kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.
8. Të realizojë Projektin e Zbatimit në përputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundojë punimet në përputhje me volumet e punës për çdo zë të preventivuar për jo më shumë se **182 ditë nga nënshkrimi i kesaj kontrate.**
9. Të pranojë çdo ndryshim jo thelbësor të miratuar nga Investitori në Projektin e Zbatimit dhe në Preventivin e Zbatimit brenda vlerës së Kontrates.
10. Gjate kryerjes së punimeve, të njoftojë në kohë dhe zyrtarisht Investitorin për ato raste të mosperputhjes së Projektit të Zbatimit dhe të Preventivit të Zbatimit. Deri në paraqitjen zyrtare të qendrimit të Investitorit për çeshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet të ndërprejë (pezullojë) punimet.
11. Periudha e ndërprerjes së punimeve duhet të pasqyrohet në Proces-Verbalin përkatës dhe të vërtetohet nga Mbikqyresi i punimeve. Periudha e ndërprerjes të punimeve për arsye




e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per llogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve per aq kohe sa zgjat nderprejja e punimeve.

12. Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.
13. Te siguroje vete transportin, makinerite, fuqine puntore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitur ne tender dhe te paraqese certifikatat e cilesise se tyre. **Nuk i lejohet qe rolin e sipermarresit t'ia jape nje subjekti tjetër.**
14. Te paraqese tek AK per miratim dhe per te realizur likuidimin e punimeve, Situacion/e te pjeseshm/e per punimet e kryera dhe Situacion Perfundimtar. Situacionet te jene te miratuara edhe nga Mbikqyresi i Punimeve.
15. Te njoftoje me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektivit. Ky njoftim duhet te behet jo me vone se **5 (pese)** dite para dates se perfundimit te punimeve.
16. Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.
17. Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziqet per demtimin dhe humbjen e materialeve dhe prones publike e private te te treteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.
18. T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjithë dokumentacionin shkresor te perditësuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektivit.

## V. TE TJERA

1. Menyra e komunikimit midis paleve do te jete vetem me shkrim.
2. Shoqeria "Kola Invest" sh.p.k. merr persiper te gjitha pergjegjesite dhe detyrimet perpara Bashkise Fier, si persa i perket cilesise se punimeve, afatit te kryerjes se tyre dhe çdo pergjegjesie tjeter te ligjshme qe do te rrjedhe nga kjo kontrate Sipermarrje, bazuar ne nenin 431 te Kodit Civil te R.SH.
3. Per çdo çeshtje qe lind gjate zhvillimit te punimeve, midis paleve kryhen negociata per zgjidhjen e tyre.
4. Ne qofte se Kontraktori braktis Objektivin pa e perfunduar ate, duke zgjidhur Kontraten ne menyre te njeanshme, Ai detyrohet te paguaj demin qe i shkakton Bashkise Fier dhe Garancine e Kontrates.




5. Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfunduara do të bëhen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj.
6. Palet nuk çlirohen nga cdo përgjegjesi për mos zbatimin e termave të kesaj e Kontrate, përveç se në rast të veprimit të forcave mëdha të vertetuara nga Institucionet Zyrtare.
7. Kontraktori, Mbikqyresi i punimeve dhe Kolaudatori janë të detyruar të kontaktojnë zyrtarisht me Specialistin e Investimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Publike të Bashkisë Fier, pasi ky i fundit do të jetë personi i kontaktit i cili do të monitorojë gjithë procesin e zbatimit të punimeve, për këtë objekt kontrate.
8. Për cdo ditë vonese tej afatit të punimeve, Kontraktori është i detyruar t'i paguaj Investitorit, **gjohet në masën 4/1000** të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Shpërblimi për demot e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamatën e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

Shqipëri:

9. Veprimet financiare për llogaritë të kesaj Kontrate do të kryhen me shoqërinë "**Kola Invest**" shpk, në Raiffeisen Bank nr. e llogaritë 0030061944 dhe IBAN AL6520211037000000030061944.
10. Çdo mosmarrveshje që do të lindë gjatë zbatimit të kesaj Kontrate, palet do të zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërt do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Fier.
11. Pjesë përberëse e kesaj Kontrate janë edhe Projekti i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit me cmime që është paraqitur në tender nga Sipermarresi si dhe Specifikimet Teknike të punimeve të pranuar dhe Grafiku i Punimeve.
12. Çertifikata e Garancise së Punimeve leshohet pas përfundimit të Afatit të Garancise që është **24 muaj**, pasi Kontraktori, Mbikqyresi, Kolaudatori dhe AK kanë inspektuar Objektin dhe kanë konstatuar që nuk ka defekte dhe punime të pakryera si dhe që ai funksionon në përputhje me Projektin.
13. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë Afatit të Garancise së punimeve të ndertimit, AK llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e Garancise së punimeve që është në masën **5%** të vlerës totale të Kontratës.
14. Çmimet e punimeve do të jenë ato të fituara në tender, sipas preventivit të paraqitur nga Sipermarresi.
15. Bashkia Fier mund të bëjë në çdo kohë porosi tek Kontraktori për të bërë ndryshime (specifikime teknike) brenda qellimit të përgjithshëm të kontratës.
16. Kontraktori është i detyruar që të njoftojë dhe të rakordojë përpara, në vazhdim dhe në përfundim të punimeve me KESH, ALBTELEKOM, UJESJELLES-KANALIZIM sh.a për zgjidhjen bashkarisht të problemeve të infrastruktures së tyre, që të jenë prezente me specialistet e tyre kur do të kryhen punime të cilat kanë të bëjnë me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve të cilat janë ekskluzivitet i subjekteve të mesipërme. Afati i njoftimit për këto subjekte do të jetë 5 (pese) ditë përpara kryerjes së punimeve.



17. Kjo Kontrate hartohet ne 6 kopje, 1 per Kontraktorin dhe 5 per Bashkine Fier dhe pasi lexohet nga palet, nenshkruhet prej tyre me vullnet te lire ne Fier sot me date 08/08/2017.

**Adresa :**

Bashkia Fier, L. "Kastriot", Rr. "Brigada e XI Sulmuese"  
[www.bashkiafier.gov.al](http://www.bashkiafier.gov.al) Fier

**Adresa :**

O.E "Kola Invest sh.p.k"  
Lagjja 'Kryengritja'; Rruga 'Aulona'  
Kompleksi 'Apollon'; Pallati nr.7;  
Zona Kadastral Nr.8531; Nr.Pasurie  
8/59, Fier.

Për dhe në emër të :

**AUTORITETIT KONTRAKTOR  
BASHKIA FIER**

Për dhe në emër të :

**KONTRAKTORI  
KOLA INVEST sh.p.k**

**Armando SUBASHI**  
**KRYETAR I BASHKISE**  
**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM**  
**Florjan MUÇAJ**



**Sofokli KOLA**  
**PËRFAQËSUES I LIGJOR**

